

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, kryesuese e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gëzim Çopa, me arsyetimin sa vijon:

1. Lidhur me vlerësimin e pasurisë

Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e pasurisë në Sh, Durrës

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar të ardhura në vlerën 155.800 euro, për periudhën 1998 – 2003, me burim nga qiradhënia e banesës në Rr, Durrës, shoqërisë ndërkombëtare “***”, dhe punësimi i tij *part-time* për një periudhë të caktuar në këtë shoqëri.

Në deklaratën e fillimit të detyrës si oficer i policisë gjyqësore pranë seksionit të Prokurorisë, në vitin 2005, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia për periudhën 2000 – 2004, në vlerën 36.000 USD/vit.

Deklarimet kontradiktore të subjektit gjatë procesit krahasuar me deklarimin periodik të tij krijojnë paqartësi dhe nuk provojnë se kur dhe sa realisht janë përfituar, lidhur me kohën e shumën.

Përveç sa më sipër, lidhur me pagesën e tatimit mbi këto të ardhura personale nga qiraja para vitit 2001, detyrimi ishte i subjektit të rivlerësimit si deklarues i përfitimit të këtyre të ardhurave, që, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të paguante tatimin në organin tatimor, fakt që nuk rezulton të jetë provuar gjatë hetimit administrativ.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8841, datë 11.12.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, qiramarrësi person fizik/tregtar paguante shumën e qirasë dhe kishte detyrimin të paguante në organin tatimor tatimin përfundimtar.

Nuk rezulton që shoqëria ndërkombëtare “***” të ketë qenë subjekt i regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe duke mos qenë person fizik apo juridik rezident tregtar në shtetin shqiptar, ajo nuk mund merrte rolin e agjentit për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimeve, ndaj ishte detyrim i subjektit të rivlerësimit si deklarues i përfitimit të këtyre të ardhurave, të paguante tatimin në organin tatimor, fakt që nuk rezulton të jetë provuar gjatë hetimit administrativ.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiradhënia e pasurisë së paluajtshme, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Arsyetimi se subjekti ishte përfitues në vazhdim i këtyre të ardhurave dhe nuk kishte dijeni apo një sjellje bashkëpunuese lidhur me mosprovueshmërinë e pagimit të detyrimeve tatimore mbi to, nuk i shërben në mënyrë domethënëse situatës konkrete të subjektit të rivlerësimit.

Në analizë të deklarimit të vitit 2005, ku subjekti deklaronte pronësinë 100% mbi shtëpitë dhe të ardhurat nga dhënia me qira, si dhe mbi gjendjen në llogarinë bankare, mbetet i paprovuar dhe deklarativ pretendimi i subjektit se këto ishin të ardhura të përfituara nga nëna e se ai ishte përfitues në vazhdim i tyre.

Në kushtet kur, sipas deklaramit të subjektit, ai kishte punuar si ekonomist *part-time* i shoqërisë qiramarrëse, ky fakt i mundësonte atij dijeninë mbi mospagimin e detyrimeve tatimore, duke rrëzuar pretendimin e tij se nuk kishte dijeni lidhur me mosprovueshmërinë e pagimit të detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiratë apo puna e tij.

Sa më sipër, të ardhurat në vlerën 155.800 euro, nuk provohen se kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, pasi ato janë jo vetëm të paprovuara se janë përfituar lidhur me kohën e shumën, por edhe të panënshtuara pagimit të detyrimeve tatimore, ndaj këto të ardhura nuk duhen konsideruar si të ardhura që plotësojnë standardin kushtetues e ligjor të të ardhurës së ligjshme për efekt të këtij procesi e, për pasojë, të ardhurat në vlerën 155.800 euro nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.

Lidhur me të ardhurat nga shitja e tokës dhe kalçetos në Sh, Durrës

Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar të ardhura nga shitja e fushës së minifutbollit dhe lokalit në vitet 2005 – 2006, në Rr, Durrës, në vlerën 48.000 euro (investuar 47.000 euro/shitur 95.000 euro), duke deklaruar se me kontratë shitjeje çmimi i dakordësuar ishte 3.000.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër me deklaratë noteriale.

Referuar të dhënave të kontratës së shitjes nr. ***, datë 5.11.2005, vlera e dakordësuar nga palët dhe e pasqyruar në kartelën e regjistrit të pasurisë në emër të blerësve në ZVRPP-në Durrës ishte vlera 3.000.000 lekë.

Deklarimi i subjektit se kjo pasuri u është shitur blerësve në vlerën 95.000 euro nuk provohet me dokumentacion ligjor provues dhe mbetet vetëm deklarativ, pasi vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 690 të Kodit Civil.

Deklarata noteriale nr. ***, datë 23.1.2017, e shtetasve A. Xh dhe A. B, e bërë gjatë plotësimit të deklaratës *Vetting*, ka vlerë të kufizuar ligjore, pasi palët kanë pasur të gjitha mundësitë ligjore të parashikonin sa pretendohet në hartimin e dokumentit ligjor të kryerjes së veprimit juridik mes tyre.

Për sa nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkuara në kontratën noteriale të shitjes nr. ***, datë 5.11.2005, të lidhur mes palëve, përfshirë këtu çmimin e parashikuar, e dakordësuar nga palët se do të ishte 3.000.000 lekë vetëm kjo vlerë, konsiderohet vlerë e provuar me dokumentacion ligjor provues dhe përfshihet në analizën financiare.

Marrja në konsideratë e shumës 47.000 euro, si vlerë investimi dhe shitje, nuk i shërben situatës konkrete të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë jo vetëm sa më lart analizuar, por edhe sa në deklaratën e fillimit të detyrës si oficer i policisë gjyqësore pranë seksionit të Prokurorisë, në qershor të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investim të kryer që lidhet me këtë pasuri.

Sa më sipër, lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës dhe kalçetos në fshatin Sh, Durrës, provohet se kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, vetëm për vlerën 3.000.000 lekë, ndaj vetëm këto të ardhura duhen konsideruar si të ardhura që plotësojnë standardin kushtetues e ligjor të të ardhurës së ligjshme për efekt të këtij procesi e, për pasojë, duhet të përfshihen si të tilla në analizën financiare.

Lidhur me të ardhurat nga shitja e tokës bujqësore me sip. 1.750 m², në Sh, Durrës

Me kontratë shitblerjeje trualli datë 4.1.2013, shtetasit Gëzim, F, F, E, R dhe B.Ç i shesin shoqërisë “****” sh.p.k. truallin me sip. 1.750 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në Sh, Durrës, me çmim 210.000 euro = 29.400.000 lekë.

Në kontratën e shitblerjes së truallit nr. ***, datë 4.1.2013, në nenin 6 të saj përcaktohet nga palët se bazuar në Udhëzimin nr. 21, datë 21.2.2009, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, pika 1 dhe pika 6.2 e këtij Udhëzimi dhe shtojca nr. 1 e tij, Udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, të Këshillit të Ministrave, dhe në veçanti në vendimin nr. 1620, datë 26.11.2008, “Për miratimin e trojeve që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna”, çmimi minimal fiskal në territoret e Komunës Rr është 8.400 lekë/m² për truall, për efekt tatimi për fitimin e realizuar nga e drejta e kalimit të pronësisë. ZVRPP Durrës ka të drejtën e përlllogaritjes së mëtejshme të pagesës që pala shitëse detyrohet të bëjë në atë zyrë.

Lidhur me të ardhurat nga shitja nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, përcaktuar në kontratën e shitblerjes së truallit nr. ***, datë 4.1.2013, në nenin 6 të saj.

Për më tepër, nga hetimi administrativ nuk u provua se regjistrimi në emër të blerësit të pasurisë ishte bërë për shumën e referuar në kontratën e shitblerjes në ZVRPP-në Durrës, për sa në kartelën e regjistrimit të pasurisë në emër të blerësve nuk kishte asnjë vlerë të përcaktuar dhe referuar shumën e paguar për këtë pasuri, duke mos e provuar vlerën e paguar për kalimin e pronësisë së kësaj pasurie.

Shpjegimet e datës 21.2.2024, të dërguar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, nuk i shërbejnë situatës konkrete të subjektit të rivlerësimit për të provuar pretendimet e tij, pasi ato nuk provojnë, së pari, çmimin e kalimit të kësaj pronësie dhe, së dyti, pagimin e detyrimeve referuar çmimit të paguar, sipas Udhëzimit nr. 21, datë 21.2.2009, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, pika 1, pika 6.2 e këtij Udhëzimi dhe shtojcës nr. 1 të tij, Udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, të Këshillit të Ministrave.

Subjekti nuk ka arritur as të provojë apo shpjegojë interesin dhe përfitimin e palës blerëse në këtë rast, pasi i vetmi përfitues nga ky veprim ka qenë vetë ai, si mbartës i detyrimit për pagesën e tatimit për kalimin e pronësisë.

Subjekti, si deklarues dhe përfitues i të ardhurave në vlerën 210.000 euro = 29.400.000 lekë, nuk provoi se këto të ardhura kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, ndaj dhe ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

Lidhur me të ardhurat nga shitblerja e tokës arë me sip. 1.462 m², Sh, Durrës

Pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, në Sh, Durrës, rezultoi se ishte blerë nga z. Gëzim Çopa, në datën 27.6.2005, me kontratën nr. ***, me çmim 760.000 lekë.

Kjo pasuri u deklarua nga subjekti se ishte shitur me kontratën nr. ***, datë 3.10.2007, kundrejt çmimit 10.000.000 lekë.

Shpjegimet e subjektit lidhur me barrën e provës për sa Komisioni ngriti dyshime mbi vërtetësinë e këtij transaksioni lidhur me pasurinë e llojit “tokë arë” në kushtet kur subjekti e ka shitur pasurinë për një çmim rreth 13 herë më të lartë nga çmimi i blerjes, vetëm pas rreth dy vjet e tre muaj pasi e kishte blerë, nuk ishin bindëse dhe as të provuara me dokumentacion.

Përveç pasurisë së mësipërme, rezultoi se subjekti në datën 27.10.2003 ka blerë nga shtetasi I.Z pasurinë e llojit tokë-arë me sip. 1,002 m², ndodhur në Sh, Durrës, z. k. ***, vol. ***, f. ***, për çmimin 500.000 lekë dhe në datën 3.3.2005 ka blerë nga familja K pasurinë e llojit tokë-arë me sip. 1,715 m², ndodhur në Sh, Durrës, z. k. ***, vol. ***, f. ***, për çmimin 800.000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se të ardhurat e pretenduara me burim nga marrëdhënia e qirasë dhe ajo e punësimit me shoqërinë “****” plotësojnë standardin kushtetues e ligjor të të ardhurës së ligjshme për efekt të këtij procesi. Për rrjedhojë, subjekti nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive të paluajtshme referuar me këtë burim krijimi, ndër to edhe pasurinë objekt vlerësimi tokë bujqësore sip. 1.750 m².

Duke konsideruar veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, që në filluesën e tyre, si të afektuara me kryerjen e veprimeve juridike të pashpjegueshme në një kontekst logjik e ligjor të qarkullimit civil të sendeve dhe gjithashtu me mungesë burimi të evidentuar, që në krijimin e saj, subjekti nuk ka arritur të provojë burimet e ligjshme të shumës 10.000.000 lekë, të përfituar në finalizimin e këtij transaksioni, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ndaj dhe ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

Në analizë të qëndrimeve lidhur me burimet e mësipërme dhe duke mbajtur në konsideratë se, ndonëse jo në detyrën e prokurorit subjekti ka kryer funksionet e oficerit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë në periudhën qershor 2005 – janar 2009, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2. Lidhur me kontrollin e figurës

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gëzim Shyqyri Çopa.

Në funksion të verifikimit të informacioneve të përfutuara nga institucionet e verifikimit, u administrua dosja e procedimit penal nr. ***/***, hetuar nga subjekti si pjesë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Pas verifikimit dhe analizimit të kësaj çështjeje penale dhe akteve pjesë përbërëse të saj, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, duke i kërkuar shpjegime dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor lidhur me konstatimet dhe gjetjet në kryerjen e veprimeve hetimore në dosjen e procedimit penal nr. ***/***.

Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë arsyet/rrethanat/faktet/provat, të cilat çuan në ndryshimin e cilësimit të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim, duke dëshmuar përpjekje të tij për minimizim të rëndësisë së faktit penal dhe rrezikshmërinë e veprës.

Gjetjet lidhur me këtë procedim, në vlerësim të raportit të AKSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, mbështesnin informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.

Rrethanat konkrete dhe motivet e subjektit, që mbështesnin veprimtarinë e tij në procedimin penal të përshkruar më lart, afektojnë nënindikatorin e integritetit të parashikuar nga neni 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

Në këndvështrimin e përgjithshëm, edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, mospërmbushja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së tij, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, bazuar në sa më sipër arsyetuar kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gëzim Çopa, pasi lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm, në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe për sa në vlerësimin tërësor subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE
Kryesuese (kundër)